

Xhemile Saliu, MA¹

UDC:
347.44:[348:28

**E DREJTA KONTRAKTORE NË JURISPRUDENCËN ISLAME
DHE SPECIFIKAT ESENCIALE TË SAJ**

**ДОГОВОРНО ПРАВО ВО ИСЛАМСКОТО
ЗАКОНОДАВСТВО И ОСНОВНИТЕ НЕЈЗИНИ
КАРАКТЕРИСТИКИ**

**CONTRACTUAL LAW IN ISLAMIC JURISPRUDENCE AND ITS
ESSENTIAL SPECIFICITIES**

Abstract

At first glance, Islamic contractual law is a huge blessing for comparative lawyers for two reasons: its independence from other legal systems and its current renaissance in the Muslim world. First, it requires a special kind of independence from other systems. On the one hand, it acknowledges that the trade and conventional customs prevailing in the Middle East in the Years of its formation represented a good part of its contents. As such, many of its legal rules and formulations remind many of the Jewish, Romany (Vizant) and Vavilion law. But on the other hand, it believes that Muhamed (s.a.w.s), The Islamic Prophet, published the unique Islamic contract law during his 23 year of prophecy. However, it allows for the survival of the dominant customs if they are not in conflict with it.

The later generations looked at a similar attitude in relation to the customs that faced the vast Muslim conquests. But over time, lawyers took over the task of processing the collected material in order to emphasize the Islamic character and to unite them in a single corpus, and further emphasized the significance of the discovered norms. In Sharia

¹Assistant, Faculty of law – University of Tetovo/ xhemile.saliu@unite.edu.mk

contractual law, it is consider that the rules are given for all times. The corpus of Islamic contract law, elaborated by religious teachers by using various methods, is itself to guide the human being towards a religious, moral and ideal goal when dealing with the issue of contract. The facts ask for it, to leave every term, which is the relic of the past, which it no longer holds. But repeated research highlights how historical Islamic law has transformed itself to respond to time challenges, which is the power that can still have today.

Keyword: contractual sharia law, independence from other systems, guide the human being towards a religious, moral and ideal goal.

HYRJJE

Tekstet mbi kontratat

Në këtë punim, do të bëjmë hyrje në perceptimet morale dhe religjioze që kanë pasur ndikim dominues në të drejtën kontraktore. Këto perceptime janë dhënë nëpërmjet civateve të teksteve më kryesore: Kur'anit dhe sunetit për kontratat dhe të drejtën tregtare. Analizat tona, nuk i mbështesim mbi konotacionin historik as duke analizuar rregullat e fikhut². Në vend të mënyrave të lartpërmendura ne i paraqesim këto burime vetëm si fakt literal. Fakti se e drejta në Sheriat, nuk formohet nga organi ligjdhënës, por e drejta rrjedh direkt nga Shpallja Hyjnore, e bën këtë të drejtë të jetë edhe më misterioze dhe më rëndë për t'u analizuar nga njerëzit. Për të nxjerr të drejtën në Sheriat, duhet të kuptohet Gjuha Hyjnore, gjegjësisht tek e Drejta e Sheriatit, mund të themi se e drejta rrjedh në mënyrë analoge (duke përdorur analogjinë) nga Shpallja Hyjnore.

Karakteristikë e veçantë është ajo, se shumë pak ajete³ në Kur'an në mënyrë direkte kanë të bëjnë me të drejtën kontraktore. Mirëpo edhe ai pak tekst ka tërhequr një vëmendje të madhe nga studiuesit e shkollave juridike islame, por edhe nga shkencëtarët e huaj që merren me sferën e të drejtës kontraktore. Nga ana tjetër, suneti përfshin numër të madh të teksteve relevante, një numër i madh i tyre, me një specifike

² Rregullat e fikhut paraqesin përpjekjet njerëzore për t'u kuptuar e Drejta Hyjnore, të cilat përpjekje e japin bazën e jurisprudencës islame.

³ Në gjuhën juridike, nene.

shumë të veçantë. Mirëpo, edhe pse Kur'ani përmban numër të vogël të ajeteve (neneve) ku rregullohet çështja e kontratave, mund të vërejmë se kjo bëhet me një Urtësi Hyjnore, **duke u përdorur metaforat tregtare**, duke u thënë pak, por që realisht me analizë detajore dhe hulumtim të thellë shkencor mbi të, të mund të zbulohet domethënia e tyre. Kjo është bërë me qëllim që njeriut mos t'i servohet gjithçka e gatshme, por njeriu të përpiqet për të hulumtuar mbi sekretet që fshihen në të dhe të vijë në përfundime konkrete duke ia përshtatur edhe kohës në të cilën jeton.

1. Etika e kontraktimit

1.1 Drejtshmëria

Ajetet Hyjnore në Librin e Shenjtë, e përsëritin në shumë vende parimin e ndershmerisë dhe ndërgjegjshmërisë. Ky parim vjen në shprehje në ajetin (nenin) përkatës ku thuhet: Masën mbusheni kur matni (me enë) dhe peshoni me peshojë të drejtë (precize). Kjo është më e dobishme dhe ka përfundim më të mirë.⁴ Nga më e lartpërmendura mund të shohim se parimi i ndershmerisë dhe ndërgjegjshmërisë bie ndesh me mashtrimin gjatë lidhjes së kontratave...

1.2. Dëshmia

Gjatë transaksioneve të ndryshme, e sidomos gjatë transaksioneve kredituese, gjegjësisht huas, jurisprudenca islame i jep theks të veçantë dëshmisë. Në Librin e Shenjtë kemi një ajet të gjatë rreth kësaj çështjeje. Dëshmia vjen në shprehje: **nëse merret hua, për një afat të caktuar**, d.m.th. në rast se është caktuar afati i rikthimit të huas, bëhet e patjetërsueshme dëshmia. Sipas ajetit, kur merret hua nga njëri-tjetri duhet që përveç palëve kontraktuese të ketë edhe: **një shkrues i drejtë i cili e vërteton atë që është kontraktuar në mes palëve dhe dy dëshmitarë**. Sipas ajetit përkatës kjo bëhet për tre shkaqe:

- 2.1. Për të respektuar parimin e drejtshmërisë
- 2.2. Është dëshmi më e fortë se është lidhur kontratë mes palëve dhe
- 2.3. Është më afër mosdyshimit.

⁴ Surja El-Isra, 17:35.

Nga parimi i dëshmisë përjashtohen vetëm kontratat që nuk caktohet kthimi i huas me afat të caktuar, gjegjësisht në rastet kur kemi të bëjmë me tregti (transaksione) të menjëhershme (dora- doras) nuk duhet të bëhet kurrfarë shënimi.⁵

1.3. Detyrimi i përmbushjes së kontratës

Jurisprudenca islame, fuqishëm e mbështet detyrimin moral për përmbushjen e kontratës dhe përmbushjen e detyrimeve të marra. Kjo vjen në shprehje në ajetin kur'anor ku thuhet: O ju që besuat! Bëhuni besnik në kontratat e juaja dhe obligimet (UKUD) që keni marrë⁶. Përkthimi korrekt i fjalës UKUD, d.m.th lidhje, lidhshmëri dhe nga kjo edhe rrjedh detyrimi dhe kontraktimi. Ky term gjithashtu asocon edhe në lidhjen e kontratës (pajtueshmëria e vullnetit të palëve (AHD) ose betim (YAMIN). Komentuesit, shprehen se, ajeti u drejtohet atyre që kanë besuar, që sinjalizon se përmbushja e kontratës është cilësi e njeriut të ndërgjegjshëm dhe besnik.

1.4. Motivimi për lidhjen e kontratës

Tek e drejta kontraktore nën ombrellën e të drejtës islame, theks të veçantë i jepet edhe motivimit, gjegjësisht arsyes se pse ndërmarrim iniciativë për lidhjen e një kontrate. Kjo e drejtë, pasi që është pjesë përbërëse e Ligjit Hyjnor, rëndësi të madhe i jepet motivimit me baza etiko-morale. Si rezultat i kësaj, qëllimi i vërtetë, apo morali i lidhjes së kontratës konsiderohet si një nga elementet më të rëndësishme. D.m.th pas kësaj fshihet ana e brendshme njerëzore, e cila duhet të jetë në përputhshmëri me rregullat morale edhe atëherë kur vendosim të lidhim kontrata.

Sipas Ibn Kajimit: “Motivi prapa lidhjes së kontratave është një konsideratë thelbësore dhe ndikon në vlefshmërinë e tyre”⁷. Kështu që, sipas këtij parimi, në qoftë se, kontrata e cila në vetvete përmbush të gjitha kriteret e vlefshmërisë dhe nëse të gjitha paraqitjet nuk përmbajnë as një element të paligjshëm, sërish mund të paraqitet si një kontratë e pavlefshme, për shkak se gjatë lidhjes së asaj, motivimi ka qenë i papërshtatshëm sipas parimeve etike. Andaj, lirisht mund të themi se

⁵ Surja El-Bekare, 2:282.

⁶ Surja El-Maide, 5:1.

⁷ Imes Working Papers series no.15/ Philosophy of the Islamic Law of contract/A comparative study of contractual justice, Hideyuki Shimizu, page 16.

si element esencial i lidhjes së kontratës, tek e drejta shariatike, paraqitet edhe motivimi apo qëllimi i brendshëm, i cili duhet të jetë në përputhje me moralin hyjnor. Andaj, mund të shihet se, e drejta kontraktore shariatike, për dallim nga kontratat e sistemeve tjera juridike, i jep theks të veçantë aspektit subjektiv të palëve kontraktuese dhe motivimit të tyre të brendshëm për lidhjen e kontratës dhe më pak i kushtohet vëmendje formalitetit të lidhjes së kontratës.

2. Specifikat e kontratave në jurisprudencën islame dhe ndalesat e parashikuara

Gjatë lidhjes së kontratave, në sheriatin e së drejtës islame, merret parasysh edhe mbarëvajtja e gjithë shoqërisë, gjegjësisht edhe pse kontratat lidhen në mes palëve kontraktuese dhe vlen *parimi inter partes*, sërish theks të veçantë dhe rëndësi të madhe i jepet edhe të mirës mbarëshoqërore. Andaj, edhe në sheriatin islam, gjatë lidhjes së kontratës duhet të respektohen disa çështje specifike, të cilat paraqiten si specifika vetëm në të drejtën shariatike kontraktore. Si specifikë mund të përmendim edhe çështjen e elementeve të cilat elemente e bëjnë një kontratë të pavlerë. Këto elemente janë: ikrah (obligimi), galat (gabimi), tagrir (mashtrimet), gubn (jo-konfirmimi) dhe kontratat për gjërat e ndaluara⁸.

Ikrah (obligimi). Sa i përket lidhjes së kontratave, paraqitet si obligim ligjor, që përmbushja e kontratës të bëhet nga ana e palëve procedurale, në lidhje me marrëveshjen që e kanë arritur për elementet esenciale të kontratës. Mirëpo *ikrah (apo detyrimi)* në jurisprudencë islame do të thotë të obligosh tjetrin për të bërë diçka kundër vullnetit subjektiv të tij. Llojet e këtij detyrimi ndahen në: 1.1 *Ikrah Mulji - Duress* - ku pala tjetër detyrohet të kryej një gjë kundër vullnetit subjektiv, duke u bërë kërcënimi i shkaktuar nga një goditje dhe 1.2 *Ikrah Ghayr Mulji - Duress* - duke u kërcënuar individi për të kryer një detyrim pa pasur vullnet, duke i shkaktuar kështu një goditje e cila goditje le pasoja të dhimbjes. Shumica e juristëve, pohojnë se detyrimi shkakton anulimin e kontratave, duke u bazuar në hadithin e Muhamedit a.s: “Me të vërtetë Zoti nuk e ngarkon popullin tim për atë që është bërë gabimisht, nga harresa, dhe për gjërat që bëhen nën detyrim”. (Sunen,

⁸ Razali Hj Nawawi, Islamic Law on Commercial Transactions, Kuala Lumpur: CT Publications, 1999, f. 21. 2, Ibid.

Ibn Maxhe)⁹. Mirëpo, edhe pse i definuar në përgjithësi, një veprim do të mund të konsiderohet si ikrah apo detyrim kundër vullnetit subjektiv të individit nëse plotësohen disa kushte. Ato kushte janë: a) nëse ekziston kapaciteti apo aftësia për ekzekutimin e kërcënimit; b) kërcënimi apo detyrimi është real; c) shkaktohet një dëmtim serioz palës e cila detyrohet të kryejë një veprim ç) veprimi është i menjëhershëm dhe d) pas kryerjes së atij detyrimi fshihet një qëllim joligjor apo i paligjshëm.

Pasi të plotësohen të gjitha këto kushte dhe të konstatohet gjendja aktuale e cila është paraqitur pas detyrimit të paraqitur ndaj palës, atëherë paraqiten edhe efektet e ikrah-ut apo detyrimit. Si një ndër efektet kryesore të lidhjes së kontratës nën detyrim është anulimi i po asaj kontrate. Mirëpo, në rast se pala e cila është detyruar për lidhjen e kontratës nën kërcënim, atëherë nëse ajo shpreh vullnet për mos-anulimin e saj, atëherë lejohet mos-anulimi i saj.

Andaj, në këto rrethana mund të themi se kontrata e tillë do të prodhojë efekte juridike. Dhe si efekti i fundit i saj, paraqitet edhe pezullimi i një kontrate të tillë¹⁰.

Si element i dytë na paraqitet **galat** apo ndryshe thënë **gabimi**. Gabim juridik, sipas të drejtës islame, kemi në rastet kur jepen informacione, të cilat informacione nga ana kundërshtare nuk kuptohen drejtë. Gabimi, është dhënia e informacionit nga njëra palë, por që dhënia e informacionit nuk ka pasur për qëllim që palën tjetër ta vë në pozitë mashtruese, por që informacioni i gabuar, ka depërtuar deri tek pala tjetër, pa ndonjë qëllim lajkatar. Sa i përket gabimeve në jurisprudence islame kontraktuese, kemi të bëjmë me gabime që shfaqen në lëndën apo objektin kontraktues, përbërjen e saj, cilësinë dhe sasinë e saj.

Sa i përket gabimit në aspektin e lëndës, kontrata do të konsiderohet e pavlefshme¹¹. Shembull, nëse palët kontraktuese, gjatë kohës kur kanë lidhur kontratën janë marrë vesh që si objekt i kontratës të qirasë, do të jetë banesa e caktuar, dhe më pas konsiston se objekti i kontratës nga qiradhënësi në fakt, ka qenë një shtëpi e caktuar, atëherë në këtë rast kontrata e tillë, do të konsiderohet e pavlefshme.

Si element i tretë ndalues, na paraqitet edhe **Ghubn** apo **pabarazia**. Pabarazia paraqitet në rastet kur çmimi i caktuar dhe objekti

⁹ Elementet e ndaluara të një kontrate sipas islamit, Dr. Islam Hasani.

¹⁰ 2015/09/ilt-islamic-law-of-transaction.pdf

¹¹ Elementet e ndaluara të një kontrate sipas islamit, Dr. Islam Hasani.

i kontratës nuk janë proporcionalisht të barabarta sa i përket vlerës së tyre materiale. Në të drejtën tonë, përdoret termi, dëmtimi përtej gjysmës. Në këto raste, pala kundërshtare mund të kërkojë prishjen e kësaj kontrate dhe kontrata e tillë, nuk do të sjell efekte juridike në të ardhmen. Mirëpo, juristët kanë opinione të ndryshme rreth standardeve të matjes, së ç'është pabarazia e parëndësishme dhe pabarazia e tepërt. Disa juristë pohojnë se, nëse kjo pabarazi bie me juridiksionin e vlerësuesve, konsiderohet pabarazi e parëndësishme., ndërsa nëse nuk bie me juridiksionin e tyre, atëherë quhet pabarazi e tepërt.

Për shembull, janë shpenzuar pesëdhjetë dollarë më shumë për të blerë një makinë, që konsiderohet si pabarazi e parëndësishme; mirëpo, nëse janë shpenzuar më tepër se pesë mijë dollarë, atëherë konsiderohet pabarazi e tepruar. Juristët e tjerë kanë përcaktuar një shumë fikse për matjen e asaj që përbën pabarazinë e parëndësishme dhe pabarazinë e tepërt. Muhamed bin el-Hasan esh-Shejbani pohon se kjo shumë është pesë për qind e çmimit real të një sendi, dhe, nëse pabarazia është pesë për qind a më pak, konsiderohet e parëndësishme, por nëse është më shumë, konsiderohet e madhe apo e tepërt. Kështu që, sipas juristëve, pabarazia e vogël nuk shkakton efekte juridike ndaj kontratave të tilla, për dallim nga pabarazitë e mëdha, të cilat si efekt juridik kryesor e kanë anulimin e kontratës¹².

Një element tjetër kyç ndalues është edhe lidhja e kontratave për shitblerjen e sendeve të cilat sipas etikës morale-islame janë të ndaluara. Këtu bëjnë pjesë të gjitha kontratat që si objekt shitjeje kanë mishin e dërrit, alkoolin, kafshët e ngordhura apo qoftë edhe ndonjë objekt tjetër shitjeje. E gjithë kjo bazuar në dispozitën hyjnore, ku bëhet e ndaluar ngrënia e tyre¹³, e me këtë juristët e së drejtës islame, duke bërë komentimin e këtyre dispozitave duke u bazuar në principet morale dhe arsyeshmërinë e dëmit shëndetësor që i shkaktojnë produktet e tilla në shëndetin e njeriut¹⁴, e kanë ndaluar edhe çdo transaksion apo lidhje kontratash në lidhje me këto objekte (lëndë).

¹² Elementet e ndaluara të një kontrate sipas Islamit, Dr. Islam Hasani.

¹³ Surja El-Bekare, 173 dhe surja El-Maide, 3.

¹⁴ Mjeku Dr. Muhamed Nezar Dakir në një hulumtim të tij thotë: “Derri është kafshë që ushqehet me bimë, por edhe me mish, në të ka cilësi të kafshëve të buta por edhe të atyre të egra. Derri ha gjithçka, ai është një kanoçe fshirëse e oborreve dhe fushave, ai ha plehurat, mbeturinat dhe papastërtitë me shumë apetit, njëkohësisht edhe kafshon me dhëmbët e tij, sepse i ha minjtë dhe gjallesa të tjera po ashtu”. Thuhet se derri përmban 450 sëmundje prej të cilave 28 ngjitëse, disa prej të cilave janë: dizenteria - sëmundje e lukthit ku jashtëqitja përzihet me gjak, botulizmi - një lloj helmimi,

Specifika më e rëndësishme që e dallon jurisprudencën islame dhe transaksionet sipas parimeve të tilla, nga transaksionet bashkëkohore është aspekti i kamatës, apo ndryshe thënë në jurisprudencën islame, **riba**. Termi riba, do të thotë tepricë, apo nëse interpretohet sipas jurisprudencës islame kjo do të thotë kompensim i tepërt pa ndonjë shkak. Ndalimi i saj, parashihet me dispozitat hyjnore¹⁵.

Zakonisht, në kohën tonë bashkëkohore, parashtrohet pyetja, përse pikërisht transaksionet ku përfshihet edhe kamata, janë të ndaluara? Gjëja më kryesore, e ndalimit të saj, është shkaktimi i humbjes apo varfërimit të individit apo edhe shoqërisë, e cila si pjesë të transaksioneve të saj ka edhe kamatën. Edhe pse, varfërimi në afat të shkurtër kohor, nuk mund të ndihet, nëse bëhen krahasimet duke analizuar një periudhë kohore më të gjatë, do të vërejmë humbjet dhe varfërimin që e sjell ajo. Shpjegimin më të mirë duke u bazuar në praktikë, e paraqet presidenti i Nigerisë, i cili në vitin 2000 në Samitin e G8 citon aspektin praktik të humbjeve që i sollën transaksionet ku përfshihej edhe kamata, shtetit të tij. Këtë aspekt, do ta tregojmë me shembullin vijues:

Borxhi shtetëror (nëse nuk përfshihej kamata)	Borxhi që u pagua dhe duhej të paguhej (me përfshirjen e kamatës)
<i>Vitet e '90-ta</i>	<i>Vitet e '90-ta</i>
<i>\$5 bilionë dollarë</i>	<i>u paguan 16 bilionë dollarë (por kishin borxh edhe 28 bilion dollarë)</i>

Sipas tij, shuma prej 28 bilionë dollarë, erdhi si shkak i aspektit të padrejtë të normave të interesit (kamatës). Në fund, presidenti i Nigerisë thekson: “Nëse më pyetni se cila është gjëja më e keqe në botë, unë do të them se është interes i ndërthurur”¹⁶.

Sa i përket transaksioneve nëpërmjet kredive, ku pjesë përbërëse është edhe kamata, bankat me parimet islame, nuk japin kredi të tilla, kështu që nga huadhënia dhe huamarrja nuk lind kamata.

krimbat ascaris - që paraqitet në zorrë e ndonjëherë është edhe vdekjeprurëse, sëmurë mëlcinë, zgjaton qelizat individuale bakterore etj.

¹⁵ Surja El-Bekare, 275, Zoti e ka lejuar shitblerjen, ndërsa e ka ndaluar kamatën.

¹⁶ Basic Islamic Finance and Islamic contracts, page 2, Al Alawi & Co-Advocates and Legal Consultants.

3. Kamata si specifikë e veçantë në transaksionet e ndryshme dhe arsyeshmëritë që fshihen pas ndalesës së saj në jurisprudencën islame

Shitblerja dhe transaksionet e ndryshme, sipas parimeve islame nuk ndalohen, mirëpo interesi që eventualisht mund të lind nga transaksionet e tilla paraqitet si ndalesë. Sigurisht, ndalesat e tilla, nuk lindin pa shkaqe të caktuara, e posaçërisht pa pasur dobi individit dhe shoqëria me aspektin e ndalimit të saj.

Shkaqet e ndalimit të saj janë të shumta, kështu që ato ndahen në disa nivele. Si nivel i parë paraqitet, niveli individual dhe më pas edhe niveli shoqëror.

3.1 Niveli individual

Si arsye kryesore pas ndalimit të kamatës gjatë bërjes së transaksioneve të ndryshme paraqitet aspekti i varfërimit të individit i cili merr pjesë në transaksionet e tilla. Argumentet janë se, transaksionet me kamatë, shkaktojnë nivel egoizmi dhe lakmie, dhe në këto situata, huadhënësi me çdo kusht kërkon pagimin edhe të borxhit fillestar, por edhe të kamatës, pa marrë parasysh situatat në të cilat gjendet huamarrësi. Argumenti bëhet gjithnjë edhe më i fortë kur pala huamarrëse është një person që ka nevojë për kredi për të përmbushur një aksident të paparashikuar ose emergjencë. Në këtë situatë, huamarrësi është ekonomikisht më i dobët. Ai është në një pozitë të pabarabartë, pa ndonjë mundësi për të zgjedhur. Kështu që kjo lidhje nuk është kurrë e drejtë dhe e barabartë, sepse vetëm njëra palë mbulon rrezikun dhe tjetri gëzon një fitim fiks¹⁷.

3.2 Niveli shoqëror

Arsyeshmëria pas ndalimit të transaksioneve ku pjesë përbërëse është kamata, paraqet faktin e asaj se shoqëria do të ndahet dhe do të klasifikohet në dy kategori njerëzish; klasa e pasur dhe klasa e nënsh-truar, gjegjësisht do të kemi situatën e aspektit social me diametër të kundërt, ku njëra pjesë e shoqërisë do të grumbullojë pjesën më të madhe të pasurisë së shoqërisë, përderisa pjesa tjetër do të varfërohet gjithnjë e më shumë si shkak i pagesave edhe të interesit. Kështu që do

¹⁷ Philosophy of Islamic Law of Contract, Hideyuki Shimizu. Për më tepër shih: Muhammad Nejatullah Siddiqi, Partnership and Profit-Sharing in Islamic Law, (London: The Islamic Foundation, 1985, pg. 5).

të krijohen raporte armiqësore në mes këtyre klasave dhe solidariteti ndërnjerëzor do të jetë dita-ditës në humbje dhe shkatërrim. Si shkak i kësaj, do të kemi një prishje të ekuilibrit shoqëror dhe një paqëndrueshmëri sociale.¹⁸

Mund të themi se, shikuar në suaza më të gjera interesi apo thënë ndryshe kamata, ndikon në mënyrë shkatërrimtare mbi sjelljen njerëzore dhe shoqërinë në përgjithësi. Kamata, ushtron ndikime katastrofike mbi moralin dhe humanitetin e shoqërisë, duke e përforcuar akumulimin e prirjes së pasurisë në më pak duar. Kjo çon në rritjen gjithnjë e më të madhe të kapitalit pa rrezik ndaj kapitalit të bazuar në rrezik, i cili më pas sjell dhe rezulton në dështime të mëdha biznesi, papunësi dhe përfundimisht në pabarazi bruto të të ardhurave dhe pasurisë në përgjithësi, të cilat më pas përfundojnë me konflikte sociale dhe kaos ekonomik.

Kështu, na paraqitet një realitet i hidhur, ku sistemet e bazuara në interes (kamatë), pavarësisht nga shkalla e saj, po krijojnë “dembelizëm” dhe “gjakderdhje mizore” shoqërore¹⁹.

Përfundimi

Në botën e globalizuar në të cilën jetojmë sot, zakonisht nënshkrimi i kontratave me vlerë interesi, është arsyeuar gjithmonë me pretekstin se, pikërisht interesi luan një rol të rëndësishëm në promovimin e kursimit, që rezulton se nuk është gjithmonë e vërtetë.

Vështrimi i përgjithshëm i ekonomistit konvencional ka qenë që kontratat e lidhura me vlerë interesi luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e kursimeve, investimeve dhe zhvillimit ekonomik.

Megjithatë, realiteti flet gjithmonë ndryshe dhe gjithmonë në terren paraqitet një tablo e ndryshme. Ka shumë faktor të tjerë si; aftësia për të kursyer, gatishmëria për kursim, niveli i të ardhurave, modeli i shpërndarjes së të ardhurave, norma e inflacionit, stabiliteti i ekonomisë dhe matjet fiskale që ndihmojnë në rritjen e kursimeve. Këto elemente

¹⁸ Philosophy of Islamic Law of Contract, Hideyuki Shimizu, pg.47.

¹⁹ An Explanation of Rationale behind Prohibition of Riba in the Doctrines of three major Religions: with special reference to Islam, Mehboob ul Hassan; (interest exerts disastrous effects on the human behavior and society).

janë shumë më me rëndësi, sesa norma e interesit për kursime dhe investime të larta²⁰.

Conclusion

In the globalized world in which we live today, usually signing contracts of interest value is always justified by the pretext that, precisely, interest plays an important role in promoting savings, which is not always true.

The general view of the conventional economist has been that value-linked contracts play an important role in promoting savings, investment and economic development.

However, reality always speaks differently and always on the ground presents a different picture. There are many other factors as well; the ability to save, readiness for savings, income level, income distribution model, inflation rate, economic stability and fiscal measures that help increase savings. These elements are far more important than interest rates on savings and high investment.²¹

Recensentë:

Doc. dr. Shpresa Alimi

Prof. dr. Bashkim Selmani

Bibliografia

• Imes Working Papers series no.15/Philosophy of the Islamic Law of contract/A comparative study of contractual justice, Hideyuki Shimizu, page 16.

• Razali Hj Nawawi, Islamic Law on Commercial Transactions, Kuala Lumpur: CT Publications, 1999, f. 21. 2, Ibid.

• Elementet e ndaluara të një kontrate sipas islamit, Dr. Islam Hasani.

²⁰ View that ‘interest plays an important role in promoting savin’ is not always true; An Explanation of Rationale behind Prohibition of Riba in the Doctrines of three major Religions: with special reference to Islam; - M. ul.Hassan; 2015, pp.73-87.

²¹ View that ‘interest plays an important role in promoting savin’ is not always true; An Explanation of Rationale behind Prohibition of Riba in the Doctrines of three major Religions: with special reference to Islam; - M. ul.Hassan; 2015, pp.73-87.

- Philosophy of Islamic Law of Contract, Hideyuki Shimizu, pg.47.
- Philosophy of Islamic Law of Contract, Hideyuki Shimizu. Për më tepër shih: Muhammad Nejatullah Siddiqi, Partnership and Profit-Sharing in Islamic Law, (London: The Islamic Foundation, 1985, pg. 5).
- Basic Islamic Finance and Islamic contracts, page 2, Al Alawi & Co-Advocates and Legal Consultants.
- Surja El-Maide, 1; Surja El-Bekare, 173, 282; Surja El-Isra, 35.